

Historiku i kërkimit te naftës ne Shqipëri


Shenjat e bitumit ne Shqipëri janë përmendur ne mënyrë te tërthortë nga natyralistët romake dhe greke me shume se 19 shekuj me pare.

Historiku i kërkimit te naftës ne territorin Shqiptar nis qysh ne periudhën 1903 – 1913, kur AGIP kreu vrojtimet e para gjeologjike. Këto studime u pasuan me shpimin e pusit te pare rreth vitit 1918 ne afërsi te Drashovicës. Pusi i pare ne thellësi 200 m, pati rezultate shume interesante për kohen.

Me vone, shumë shoqëri aksionere të shteteve perëndimore u interesuan për të shtënë në dorë koncesione nga Qeveria Shqiptare, dhe duke filluar nga viti 1925 ato kryen kërkime për naftë dhe xeherorë në rajone të ndryshme të Shqipërisë.

Marrëveshjet e para për kërkimin e hidrokarbureve, te lidhura ndërmjet Qeverise Shqiptare dhe kompanive te huaja te naftës, konsistuan kryesisht ne marrëveshjet e tipit te koncesioneve.

- Kështu më 11.3.1925 mori koncesionin e parë "Anglo Persian Oil C." (APOC), që zhvilloi kërkime për naftë në rajonet bregdetare në një sipërfaqe prej 34412 ha ku përfshiheshin Kryevidhi, Divjaka, Ardenica, Patosi e Buzmadhi. Kjo shoqëri shpoi 14 puse kërkimi me një metrazh prej 10910 ml në Ardenicë dhe në Patos. Në vitin 1930 ajo hoqi dorë nga koncesioni, megjithëse ne vitin 1927, nga disa puse kërkimi në Patos ishte marrë naftë.



- Duke filluar nga 12.3.1925 "Azienda Italiana-Petroli Albania" (AIPA) bëri kërkime për naftë në rajonet bregdetare nga Semani në gjirin e Vlorës, si dhe në rajonet e Lushnjes dhe të Kuçovës, në një sipërfaqe prej 47213 ha.

- Më 2.5.1925 "Societa Italiana Miniere di Selenizza" (SIMSA) mori ne koncesion për kërkimin e naftës rajonin e Penkovës dhe Drashovicës, në një sipërfaqe prej 2148 ha.

- "Standard Oil C. of New Jersey" më 29.6.1925 mori në koncesion për kërkimin e naftës një sipërfaqe prej 51500 ha, ku përfshiheshin kënetat e Karavastasë dhe kodrat në lindje të Durrësit.

- Shoqëria "H.H.Ruston" më 12.8.1925 mori në koncesion rajonet në veri të Patosit dhe depresionin e Myzeqesë dhe bëri kërkime për naftë në një sipërfaqe prej 8600 ha.

- Shoqëria "Syndicat Franco Albanais" mori në koncesion një sipërfaqe prej 118193 ha dhe bëri kërkime për naftë në luginën e lumit të Shushicës (Vlorë), në Kuçovë, në fushën e Shkodrës dhe të Korçës. Ajo shpoi vetëm 6 puse me një metrazh prej 2766 ml. në Korçë, Penkovë dhe Kuçovë, në këtë të fundit dy puse zbuluan pak naftë. Në vitin 1932 kjo shoqëri pushoi aktivitetin e saj.
- Shoqëria "Ferrovie dello Stato del Regno d'Italia" mori në koncesion 116825 ha në Dumre, Mallakastër, vargun e malit të Dajtit dhe një sipërfaqe të vogël në afërsi të Vlorës, në të cilat kreu kërkime për naftë.

Në vitet 1930-1932 shoqëritë angleze, amerikane dhe franceze i ndërprejnë kërkimet për naftë dhe u larguan nga Shqipëria. Kështu që kërkimet për naftë u përqëndruan në duart e shoqërive italiane.

Shoqëritë italiane AIPA dhe SIMSA shpuan 21860 ml, duke zbuluar në vitin 1928 naftë në Kuçovë. Në Drashovicë SIMSA pasi shpoi 3365 ml, pezulloi punimet sepse pusët jepnin prodhim të vogël. Pas këtyre rezultateve, nga viti 1930 AIPA përqëndroi punimet në rajonin e Kuçovës, duke shtuar volumin e shpimit kërkimeve dhe i shtriu kërkimet edhe në Patos, Zhabokikë, Elbasan, Belsh etj. Në vitin 1934 AIPA filloi shfrytëzimin e naftës në Kuçovë. Deri në vitin 1943 në Kuçovë u bënë 60732 ml shpim-kërkime dhe 636367 ml shpim-shfrytëzimi; ndërsa prodhimi i naftës arriti nivelin më të lartë me 148 mijë ton në vitin 1941.

Kërkimet dhe Punimet Gjeologjike të kryera nga shteti Shqiptar

Kjo periudhë karakterizohet nga kryerja e kërkimeve dhe punimeve gjeologjike në mënyrë të planifikuar dhe të investuara plotësisht nga Buxheti i Shtetit Shqiptar, si dhe të drejtuara nga institucionet përkatëse të tij.

1. Veprimtaritë dhe kërkimet e bëra pas vitit 1945

- Në janar të vitit 1945 Qeveria Shqiptare shpalli vendimin mbi konfiskimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme të shoqërive të huaja italiane, siç ishte ajo e naftës AGIP, ato të mineraleve të ngurta Feralba, AMMI, AcaJ etj. Me këto veprime filloi shtetëzimi i industrisë së naftës dhe asaj minerale, me të gjithë repartet ndihmëse.
- Qeveria Shqiptare, duke vlerësuar rëndësinë që kishte industria e naftës në zhvillimin e ekonomisë, në vitin 1949, mori vendimin për ngritjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Kombinatit të naftës me qendër në Kuçovë, që merrej me gjithë veprimtarinë e industrisë së naftës.

Ndërkohë ishin krijuar bazat e bashkëpunimit me grupe dhe ekspedita gjeologjike nga Bashkimi Sovjetik për vënien në efikencë të vendburimeve ekzistues dhe kërkimin e naftës e gazit në rajone të rinj.

Filloi përmirësimi i teknologjive të kërkimit, duke futur edhe metoda të reja si sizmika, gravimetria, elektrometria, gjeokimia, etj.

Si rezultat i këtyre zhvillimeve u be e mundur të zbulohen në vite një sere vendburimesh naftë si: Marinza – 1957, Visoka – 1963, Gorisht-Koculi – 1965, Ballësh-Hekal – 1966, Finiq-Krane – 1973, Cakran-Mollaj – 1977, Amonica – 1980, Delvina - 1989; dhe njëkohësisht vendburimet e gazit: Divjaka – 1963, Frakulla – 1965, Ballaj-Kryevidhi – 1983, Povelça – 1987, Panaja - 1988

Në vitin 1991, nisur nga vështirësitë e mëdha ekonomike dhe pamundësitë e kërkimit të naftës në det nga kompania kombëtare Albpetrol, u lejua futja e kapitalit të huaj fillimisht për kërkimin e naftës në det, dhe nga viti 1994 edhe në tokë. Nga bashkëpunimi me investitorët e huaj u be i mundur zbulimi i sasive të gazit dhe kondensatit në vitin 1994 në Bllokun Adriatiku-4 (në det) nga kompanitë AGIP dhe Chevron, dhe zbulimi i naftës në vitin 2001 në Bllokun 2 (në tokë) nga kompania Occidental, të cilat nuk u konsideruan komerciale.

Si rezultat i gjithë zbulimeve të sipërpërmendura dhe zhvillimit të vendburimeve, prodhimi i naftës e gazit pati një rritje të konsiderueshme, duke arritur pikun në vitin 1974, me 2,248,227 ton. (shih tabelën në vijim)



Bashkëpunimi me industrinë ndërkombëtare të naftës ka rifilluar në fillim të viteve 90. Gjatë periudhes pas viteve 1990 janë zhvilluar disa raunde licëncimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve dhe janë lidhur një numër marrëveshjesh hidrokarbure me shoqëri të huaja. Gjatë kësaj periudhe janë kryer një volum I konsiderueshem operacionesh hidrokarbure dhe janë grumbulluar një numër i madh të dhënash, të cilat shfrytëzohen për punimet në vazhdim.

AKBN promovon vazhdimisht zonat e lira. Zhvillimi i operacioneve hidrokarbure bëhet e mundur si rezultat i një legjislacioni specifik dhe mjaft efektiv në këtë fushë. Gjithashtu në këtë fushë ekziston dhe një organizim institucional mjaft i përshtatshëm. Për zhvillimin e aktivitetit të licëncimit AKBN ka hartuar procedura të cilat janë mjaft të qarta dhe mundësojnë një proces licëncimi mjaft të shpejtë.